

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. Sh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1336/2015 të datës 21.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Fatos Ajvazi dhe të akuzuarit, me datë 04.01.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S. SH. nga i ati O. dhe e ëma A. e lindur B., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin L. Komuna e Prizren, tani me banim në Prizren rruga ... pa nr. ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i tre fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 24.04.2015, në Prizren në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në rrugën ..., me rastin e shkyçjes nga rrjeti elektrik për shkak të mos përmbushjes së obligimit lidhur me pagesën e energjisë elektrike – për shkak të borxhit, ka dëmtuar vulën zyrtare – pllombën distributive, nga njehsori elektrik numër 47550822, vendosur nga ana e personit të autorizuar të KEDS – Distribucioni në Prizren dhe është kyçur në furnizim me energji elektrike, këto shenja janë vendosur për sigurimin e njehsorit elektrik.

Këso dore ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 414 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike – është nën asistencë sociale, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarit dhe anëtarëve të familjes.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1336/2015 të datës 21.12.2015 kundër të akuzuarit S. Sh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 24.04.2015, në Prizren në shtëpinë e tij familjare i akuzuari S. Sh. si shfrytëzues i energjisë elektrike në amvisërinë e tij me shifër të konsumatorit 9044172, pas kontrollit të pikës matëse nga ana e zyrtarëve të autorizuar të dëmtuarës, është konstatuar se i njëjti ka dëmtuar pllombën distributive në njëhisorin elektrik numër 47550822, ashtu që ka bërë ndërhyrje të paautorizuar në pajisjet matëse elektrike dhe ka dëmtuar pllombën distributive të cilën e kanë vendosur personat e autorizuar të KEDS – Distribucioni në Prizren. Nga kjo del se në veprimet e akuzuarit më afër të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në shqyrtimin fillestar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit, për shkak së cilës fare nuk ka administruar provat. Gjithashtu sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, sepse në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari me kohë ka qenë i njoftuar dhe atë në pajtim me nenin 246 e 244 të KPPK. Prandaj në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, gjer më tani nuk ka qenë i gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.2161/2015 të datës 04.01.2017

**Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja
Teuta Krusha**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.